



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal eshte per efekt publikimi bashke me dokumentet e tenderit)

LLOJI I PROCEDURËS: *E hapur e thjeshtuar – me mjete elektronike.*

OBJEKTI I PROCEDURES: *“Supervizion punimesh për objektin: Furnizimi me ujë i fshatit Vakuf, Njësia Administrative Kastriot”.*

KODI PERKATES NE FJALORIN E PERBASHKET TE PROKURIMIT (CPV): 71247000-1“Mbikëqyrja e punës së ndërtimit”

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,256,146 *(një milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzetë e gjashtë) Lekë pa T.V.Sh. vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.*

*(Fondi limit i mbikëqyrjes është llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016”
“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimit”.
Grupi III tarifor.)*

BURIMI I FINANCIMIT: Vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër Sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.P.P., nenit 26, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesat ligjore sipas pikës 1 të Shtojcës 8 të D.T.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të L.P.P., nenit 41, pika 4, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës (vlera e fondit limit)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e L.P.P., si dhe nenin 43, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është ”E Hapur e Thjeshtuar Shërbime”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit dhe në procedurat e prokurimit E Hapur e Thjeshtuar Shërbime si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, V.K.M. nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë bazuar është bërë në mbështetje të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e L.P.P., si dhe nenin 43, pika 4, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A

kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme **për mbikqyrje** të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", ndryshuar me V.K.M.-në nr.943 datë 28.12.2016", me kategoritë si më poshtë:

- NP-1 Punime gërmimi në tokë.
- NP-7 Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.
- NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit
- NS-9 Punime strukturore speciale.
- NS-18 Punime topogjeodezike.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A

të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me V.K.M.-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

Meqenese kemi te bejme me Mbikqyrjen e punimeve ne zbatim argumentojme se Kategorite e mesiperme jane përcaktuar ne perputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit per Objektin: **“Furnizimi me ujë i fshatit Vakuf, Njësia Administrative Kastriot”**, gjithashtu keto kategori license bazohen edhe ne projektin/ Specifikimet teknike tepunimeve te zbatimit per kete objekt.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

2.3.1 Drejtuesin e punimeve dhe Mbikëqyrësin e materialeve dhe cilësisë që duhet të jetë inxhinier **Hidroteknik ose Ndërtimi** me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, çertifikaten e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, ndjek dhe miraton cilësinë e produkteve, korrespondencën me AKUK, miraton materialet dhe cilësinë e tyre, ndjek e miraton vendosjen e tyre në objekt dhe nuk duhet të jetë I lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

2.3.1 Inxhinieri për punimet topografike që duhet të jetë inxhinier topograf me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton piketimet dhe kuotëzimin e objektit dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

2.3.3 Inxhinieri për punimet ndërtimore që duhet të jetë inxhinier ndërtimi me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

2.3.4 Inxhinieri për punimet hidroteknike që duhet të jetë inxhinier hidroteknik me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

2.3.5 Inxhinieri për punimet mjedisore që duhet të jetë inxhinier mjedisi me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton venddepozitetet e germimeve, planin e menaxhimit mjedisor, dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik fitues, para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, uhe të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

Për secilin pjestar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë:

Kontratë pune të vlefshme

Diplomë

Librezë pune

CV



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A

Licencat profesionale për mbikqyrje.

** Në këtë rast stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te references, gjithashtu argumentojme se zgjedhja e stafit të mbikqyrjes është bazuar në punimet respektive të përfshira në projekt preventivin e objektit: **“Furnizimi me ujë i fshatit Vakuf, Njësia Administrative Kastriot”**.

2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore mesatarisht **10 (dhjetë) persona** dhe të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve te fundit duke marrë si reference datën e hapjes së tenderit

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislativi në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën e 3 (tre) muajve te fundit duke marrë si reference datën e hapjes së tenderit
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislativi në fuqi për periudhën e 3 (tre) muajve te fundit duke marrë si reference datën e hapjes së tenderit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: per përcaktimin e fuqise puntore minimale te kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne shërbimet e kerkuara sipas Termave te references, për objektin: **“Supervizion punimesh për objektin: Furnizimi me ujë i fshatit Rreth Kale, Njësia Administrative Muhur”**.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje 3 muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A

2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë pajisjen e mëposhtme:

- *Paisje Total Station* *1 copë* *në pronësi ose me qira*
- *Paisje GPS* *1 copë* *në pronësi ose me qira*

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: *Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.6 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

ISO 9001:2015 *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë*

ISO 14001:2015 *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor*

ISO 45001: 2018 *Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kerkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me objektin e zbatimit që do të mbikqyret dhe janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

Shënim: Oferta ekonomike e paraqitur nga Operatori Ekonomik duhet të jetë domosdoshmerisht në përputhje me V.K.M. Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” si dhe duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të kësaj V.K.M.. Kjo kerkese bazohet dhe në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A

Të gjitha ofertat që do të jene me vlere me të ulët se vlera minimale ose më të lartë se vlera maksimale e përcaktuar në V.K.M. Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, **do të refuzohen.**

Në rastet e bashkimit të operatorëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të L.P.P., si dhe nenit 41, pika 1, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

NJËSIA E PROKURIMIT